

Vendim nr. 58 datë 23.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtar

në datën 23.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (S) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SPIRO ÇABIRI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 00-2022-2338 (376), datë 18.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 199 e vijues dhe neni 1074 e vijues i Kodit Civil (KC); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Spiro Çabiri, me kontratën e pjesëtimit të datës 06.03.1996, është njohur si bashkëpronar në masën 40 % për një objekt të regjistruar fillimisht, në vitin 1993, në emër të V.Sh. Ky i fundit së bashku me shtetasin grek Dh.E. kanë lidhur, në datën 06.12.1991, aktmarrëveshjen për krijimin e shoqërisë “Q. E.”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin së bashku të një ndërtese dykatëshe në qytetin e Sarandës, që do të funksiononte si njësi turistike. Sipas përcaktimeve të saj, shtetasi Dh.E. do të zotëronte, në 90% të ndërtesës, pajisjet, kapitalin e lëvizjes, fitimet dhe dëmet që do të vinin prej shfrytëzimit të objektit, ndërsa shtetasi V.Sh. do të zotëronte 10% të tyre. Aktmarrëveshja nuk është regjistruar në gjykatë. Pas rikthimit në Shqipëri, bashkëpronari grek Dh. E. ka depozituar kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë për njohjen e bashkëpronësisë për objektin e ndërtuar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 254, datë 26.04.2002, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë të paditësit Dh.E., si të pabazuar në prova dhe në ligj.”*. Ky vendim është kundërshtuar nga shtetasi Dh.E.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 485, datë 10.12.2002, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 254, datë 26.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”*, sepse paditësi, duke qenë se ka kërkuar njohjen e bashkëpronësisë në bazë të nenit 199 të KC-së, nuk është bashkëpronar pasi nuk ka asnjë dokument që ta vërtetojë këtë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs shtetasi Dh.E.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 812, datë 22.04.2004, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 485, datë 10.12.2002 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.”*.

5. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 241, datë 05.09.2005, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 254, datë 26.04.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në këtë mënyrë: Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurve V.Sh. dhe Spiro Çabiri për njohjen bashkëpronar të paditësit Dh. E., në raportin 90% për paditësin dhe 10% për të paditurin [...]. Anullimin e kontratës së pjesëtimit Nr. 220 Rep., nr. 162 Kol., datë 06.03.1996. Fshirjen nga ZRPP Sarandë të regjistrimit të bërë në favor të të paditurve.”*.

6. Në kushtet kur palët nuk kanë arritur në një marrëveshje për pjesëtimin e këtij sendi të paluajtshëm të regjistruar në bashkëpronësi sipas pjesëve të caktuara në vendim, Dh.E. i është

drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar pjesëtimin në rrugë gjyqësore të kësaj pasurie.

7. Për fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës 26.10.2010, ka vendosur: *“Lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme, [...] mes bashkëpronarëve Dh.E. duke i takuar 9/10 (90%) pjesë ideale dhe Spiro Çabiri e V.Sh. duke iu takuar 1/10 (secilit nga 1/20 (5%) pjesë ideale në këtë pasuri.”*.

8. Mbi bazën e ankimit të kërkuarit dhe bashkëpronarit V.Sh., Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 236, datë 20.05.2011, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të datës 26.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.”*. Rekursi i ushtruar nga kërkuari kundër këtij vendimi nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2609, datë 17.12.2012.

9. Pas përfundimit të fazës së parë të pjesëtimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, ka vazhduar shqyrtimi gjyqësor me fazën e dytë të pjesëtimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, bazuar në nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit vlerësues të pasurisë së paluajtshme, objekt gjykimi. Sipas aktit të ekspertimit kjo pasuri nuk mund të pjesëtohej në natyrë.

10. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 371, datë 14.04.2015, ka vendosur: *“Pjesëtimin e sendit, pasurisë së paluajtshme [...] duke i dhënë fund bashkëpronësisë ekzistuese. Hotel Bar Restoranti i lihet në pronësi paditësit Dh.E. Detyrimin e paditësit Dh.E. t'i paguajë të paditurit Spiro Çabiri, si kompensim për pjesën e tij, vlerën 46 000 euro. Detyrimin e paditësit Dh.E. t'i paguajë të paditurit V.Sh., si kompensim për pjesën e tij, vlerën 46 000 euro.”*. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuari.

11. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 20-2016-589/364, datë 27.05.2016, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 371, datë 14.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs shtetasi Dh. E në datën 28.06.2016 dhe kundërrekurs kërkuari në datën 19.08.2016.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2338 (376), datë 18.10.2022, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr.20-2016-589/364, datë 27.05.2016 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.”*.

13. Kërkuesi në datën 10.02.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 00-2022-2338 (376), datë 18.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

14.1. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar dhe vlerësuar aktet dhe provat që janë administruar në dosjen gjyqësore, si dhe nuk është shprehur nëse janë vlerësuar vendimet gjyqësore të mëparshme në rigjykimin e çështjes. Njëkohësisht, ajo nuk e ka shqyrtuar rekursin në tërësinë e tij, pasi rasti nuk ka të bëjë me ndarjen e kuotave, por me pjesëtimin e sendit, ndërkohë që pjesët respektive në sendin konkret në shoqërinë e thjeshtë përcaktohen nga kuotat e ortakëve, duke vërtetuar më parë se sa është plotësuar detyrimi sipas kuotave. Për rrjedhojë, atij i është cenuar edhe *parimi i paanshmërisë*.

14.2. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë duhet ta kishte kaluar çështjen për gjykim në seancë për unifikim të praktikës gjyqësore, ndërkohë që shqyrtimi i çështjes u krye në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që

cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

17. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

19. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimin nr. 00-2022-2338 (376), datë 18.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 20-2016-589/364, datë 27.05.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendimet e këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj në themel nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka ende mjete ligjore efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tij kushtetuese të pretenduara si të cenuara, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

23. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi objekt i ankimit kushtetues individual nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen gjyqësore, prandaj kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.